

LIGJ
Nr. 70/2015

**PËR RATIFIKIMIN E DOKUMENTIT TË NDRYSHIMIT NR. 2 TË KONTRATËS
FINANCIARE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
EVROPIANE TË INVESTIMEVE PËR TERMINALIN E TRAGETEVE TË PORTIT TË
DURRËSIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet dokumenti i ndryshimit nr. 2, të kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për terminalin e trageteve të Portit të Durrësit.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.7.2015

Shpallur me dekretin nr. 9173, datë 14.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Dërguar me DHL

Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri
Në vëmendje të: z. Shkëlqim CANI/Ministër i Financave
Në vëmendje të: Ministrisë së Punëve Publike,
Transportit dhe Telekomunikacioneve
Rr. “Sami Frashëri”, nr. 33
Tiranë, Shqipëri

JUOPS/SEE/AIA/monr.
Luksemburg, 2014

Lënda: PORTI I TERMINALIT TË TRAGETEVE TË DURRËSIT (FI 23.859-SERAPIS 2004-0333)

Kontrata Financiare e lidhur nga dhe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, më 27 dhjetor 2006, në Tiranë, e ndryshuar si më poshtë (Kontrata Financiare)

AMENDIMI NR. 2 I KONTRATËS FINANCIARE

Të nderuar zotërinj,
I referohemi Kontratës Financiare të përcaktuar si më sipër.

1. INTERPRETIMI

Me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe, termat me germa kapitale, të përdorur në këtë letër, kanë të njëjtin kuptim që u jepet atyre në Kontratën Financiare. Referimet ndaj neneve janë referime ndaj neneve të Kontratës Financiare.

Në këtë letër:

“Data e Hyrjes në Fuqi” nënkupton datën në të cilën Banka i konfirmon Huamarrësit me shkrim (përfshirë edhe nëpërmjet postës elektronike) se Banka ka marrë 2 (dy) origjinale të kësaj letre, nënshkruar në përputhje me procedurën në emër të Huamarrësit, së bashku me një kopje të vërtetuar të autoritetit përkatës të nënshkrimeve, nëse nuk është dhënë deri tani, dhe se në lidhje me këtë Amendim

nr. 2, nuk nevojiten dokumente të mëtejshme për të përmbushur procesin e ekzekutimit.

2. AMENDIME TË KONTRATËS FINAN-CIARE

Në vijim të kërkesës suaj të datës 13 shkurt 2014, kemi kënaqësinë t'ju konfirmojmë se, duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi, Kontrata Financiare ndryshohet si më poshtë.

Neni 1.02(1) - Transhet

Neni 1.02(1) ndryshohet si më poshtë:

“Banka do të disbursojë Kredinë deri në 8 (tetë) transhe. Shuma e secilit transh, nëse nuk do jetë e fundit, është minimumi i ekuivalentit të 1,000,000 euro (një milion euro). Një transh që do kërkohej nga Livruesi, në përputhje me nenin 1.02(2) do të referohet më tej në këtë dokument si “Transh”.”

Neni 1.02(2) – Kërkesa për Disbursim

Në nenin 1.02(2) data “31 dhjetor 2012” do të ndryshohet dhe do të lexohet “31 dhjetor 2015”.

Neni 1.04 – Kushtet e disbursimit

a) Një nen i ri 1.04(3) me titullin “Transhi i disbursuar pas [data e kësaj letre]” do të shtohet pas nenit 1.04(2) me tekstin e mëposhtëm:

“Disbursimi i Transhit për të cilin Bankës i është paraqitur një Kërkesë Disbursimi nga ana e Huamarrësit pas [data e kësaj letre] sipas kësaj Kontrate do t'i nënshtrohet Bankës që ka marrë, nga Huamarrësi dhe/ose Livruesi, sipas rastit, në apo para datës që bie 7 (shtatë) Ditë Pune të Luksemburgut para Datës përkatëse të Parashikuar të Disbursimit, kopje të faturave që lidhen me kostot e pranueshme dhe të parashikuara, të cilat do të financohen nga Transhi përkatës që do të disbursohet në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, duke provuar që nuk kundërshtohen apo nuk i nënshtrohen ndonjë kundërshtimi përkatës dhe për përmbushjen e të cilit do të përdoren fondet e disbursuara.”.

b) Nenet aktuale 1.04(3) deri 1.04(5) do të rinumërohen 1.04(4) deri në 1.04(6).

Neni 6.01 – Përdorimi i Huas dhe fondeve të tjera të disponueshme

Neni aktual 6.01 zëvendësohet nga një nen i ri 6.01 me tekstin e mëposhtëm:

“A. Livruesi do të përdorë të ardhurat e Huas ekskluzivisht për ekzekutimin e Projektit. Livruesi do të garantojë se Përfituesi ka në dispozicion të tij fondet e tjera të renditura në pikën 2 dhe se këto fonde shpenzohen, në masën e kërkuar, për financimin e Projektit.

B. Huamarrësi do të përdorë në çdo kohë dhe do të garantojë që Livruesi dhe Përfituesi do të përdorin Huan që të financojnë kosto të parashikuara dhe të pranueshme që nuk kundërshtohen ose nuk i nënshtrohen një kundërshtimi përkatës dhe do ta provojnë këtë nëse kërkohej nga Banka.”.

Neni 6.04 - Procedura e Prokurimit

Neni aktual 6.04 ndryshohet si më poshtë:

“Huamarrësi do të garantojë se Livruesi dhe Përfituesi do të blejnë pajisje, sigurojnë shërbime dhe porosisin punime për Projektin nëpërmjet procedurave të pranueshme të prokurimit, në përputhje me kërkesat e Bankës dhe politikën e saj dhe siç përshkruhet në Manualin e saj të Prokurimit.”

Neni 6.05 - Vazhdimi i sipërmarrjeve të Projektit

Pikat aktuale “iv” me titull “Të drejta dhe leje”, “v” me titull “Mjedisi”; dhe “vi” me titull “Ligji i përgjithshëm” i nenit 6.05 ndryshohen si më poshtë:

“iv) Të drejtat dhe lejet: ruajnë në fuqi të gjitha të drejtat e kalimit ose përdorimit dhe të gjitha autorizimet e nevojshme për ekzekutimin dhe funksionimin e Projektit.

v) Mjedisore dhe sociale:

i) Të zbatohet dhe funksionojë në përputhje me Standardet Mjedisore dhe Sociale;

Për qëllimet e kësaj Kontrate:

“Standardet Mjedisore dhe Sociale” do të nënkuptojnë:

a) Ligjet mjedisore dhe ligjet sociale që zbatohen për Projektin ose për Huamarrësin, ose Livruesin, ose Përfituesin;

b) Deklaratën e EIB-it për Parimet dhe Standardet Mjedisore dhe Sociale;

c) Dokumentet Mjedisore dhe Sociale;

“Ligji mjedisor” nënkupton:

a) Ligjet e BE-së, duke përfshirë parimet dhe standardet përveç ndonjë derogimi të pranuar nga Banka për qëllime të kësaj Kontrate bazuar në marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së;

b) Ligjet dhe rregulloret e tjera të Republikës së Shqipërisë; dhe

c) Konventat dhe traktatet ndërkombëtare të nënshkruara dhe të ratifikuara nga ose që janë të zbatueshme dhe detyruese për Republikën e Shqipërisë, për të cilat objektivi kryesor është ruajtja, mbrojtja ose përmirësimi i mjedisit;

“Mjedis” nënkupton si më poshtë, në masën që ndikon në shëndetin e njeriut dhe mirëqenien sociale:

- a) fauna dhe flora;
- b) toka, uji, ajri, klima dhe ambienti;
- c) trashëgimia kulturore; dhe
- d) mjedisi i ndërtuar.

“Dokumente Mjedisore dhe Sociale” nënkupton Studimin për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social.

“Studimi për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social” nënkupton një studim si produkt i vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social që identifikon dhe vlerëson ndikimet potenciale mjedisore dhe sociale që shoqërojnë projektin e propozuar dhe që rekomandon masa për shmangien, minimizimin dhe/ose rikuperimin e çdo ndikimi. Ky projekt do t’i nënshtrohet një konsultimi publik me palët e drejtpërdrejta apo të tërthorta të Projektit.

“Deklarata e EIB-it për Parimet dhe Standardet Mjedisore dhe Sociale” nënkupton deklaratën e botuar në faqen online të EIB-it që përcakton standardet që Banka kërkon nga projektet që financon dhe përgjegjësitë e palëve të ndryshme;

“Ligj social” nënkupton secilin nga:

a) çdo ligj, rregull apo rregullore të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë në lidhje me Çështjet Sociale;

b) çdo standard të ILO-s;

c) çdo traktat, konventë apo akt të Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e njeriut, të nënshkruar dhe të ratifikuar apo që bëhet i zbatueshëm dhe detyrues për Republikën e Shqipërisë;

“Çështje sociale” nënkupton çdonjërin apo të gjitha sa më poshtë: i) kushtet e punës dhe të punësimit; ii) sigurinë dhe shëndetin në punë; iii) mbrojtjen dhe fuqizimin e të drejtave dhe interesave të popujve indigjenë, minoriteteve etnike dhe grupeve vulnerabël; iv) trashëgiminë kulturore (materiale dhe shpirtërore); v) shëndetin publik, sigurinë e jetës dhe sigurimin; vi) transferimin fizik të detyruar dhe/ose zhvendosjen ekonomike dhe humbjen e burimeve të jetesës; dhe vii) pjesëmarrjen publike dhe angazhimin e palëve të interesit;

“ILO” nënkupton Organizatën Ndërkombëtare të Punës;

“Standardet e ILO-s” nënkupton çdo traktat, konventë apo akt të ILO-s të nënshkruar dhe të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, ose që bëhet i zbatueshëm dhe detyrues për Republikën e Shqipërisë dhe Standardet Bazë të Punës (siç përcaktohen në Deklaratën e ILO-s mbi Të Drejtat dhe Parimet Themelore në Punë);

ii) të marrë, të mbajë dhe të veprojë në përputhje me Miratimet Mjedisore dhe Sociale të nevojshme apo të kërkuara për Projektin.

Për qëllimet e kësaj Kontrate, “Miratim Mjedisor dhe Social” nënkupton çdo leje, licencë, autorizim, pëlqim apo aprovim tjetër që kërkohet nga një Ligj Mjedisor apo Ligj Social në lidhje me ndërtimin dhe funksionimin e Projektit.

vi) Ligj i përgjithshëm: të ekzekutojë dhe të zbatojë projektin në përputhje me ligjet përkatëse të Republikës së Shqipërisë dhe standardet përkatëse të ligjeve të BE-së, duke përjashtuar derogimin e përgjithshëm të bërë nga Bashkimi Evropian.

Neni 6.07-Angazhimi për integritet

Neni aktual 6.07 zëvendësohet nga një nen i ri 6.07 me tekstin e mëposhtëm:

“a) Sjellje e ndaluar:

i) Huamarrësi nuk do të angazhohet dhe do të garantojë se Livruesi dhe Përfituesi nuk do të angazhohen (dhe nuk do të autorizojnë ose lejojnë që ndonjë filial apo person tjetër të veprojë në emër të tyre dhe të angazhohet) në ndonjë sjellje të ndaluar në lidhje me Projektin, ndonjë procedurë tenderimi për Projektin apo transaksion të parashikuar nga Kontrata.”.

Për qëllimet e kësaj Kontrate: “Praktikë e Ndaluar” nënkupton çdo:

a) Praktikë Shtrënguese që nënkupton dëmtimin apo lëndimin, apo kërcënimin për të dëmtuar dhe lënduar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndonjë palë ose pronën e një pale për të ndikuar në mënyrë të padrejtë te veprimet e një pale;

b) Praktikë Bashkëpunuese që nënkupton një marrëveshje ndërmjet dy apo më shumë palëve, të synuar për të arritur një qëllim të padrejtë, duke përfshirë një ndikim të padrejtë të veprimet e një pale tjetër;

c) Praktikë korruptive që nënkupton ofrimin, dhënien apo marrjen apo kërkimin, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çikaje me vlerë nga një palë për të ndikuar në mënyrë të padrejtë të veprimet e një pale tjetër;

d) Praktikë mashtruese që nënkupton çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim, që në mënyrë të vetëdijshme apo nga pakujdesia çorienton ose synon të çorientojë një palë, me qëllim që të marrë një përfitim financiar apo përfitim tjetër, apo shmangien e një detyrimi; ose

e) Praktikë penguese që nënkupton, në lidhje me një hetim për një praktikë shtrënguese, praktikë bashkëpunuese, praktikë korruptive ose mashtruese në lidhje me Huan ose Projektin: a) shkatërrimin në mënyrë të vetëdijshme, falsifikimin, ndryshimin apo fshehjen e materialit provues për hetimin; dhe/ose kërcënimin, shantazhin apo presionin ndaj një pale, për ta ndaluar atë që të zbulojë njohurinë e saj për çështje që lidhen me hetimin ose ta ndalojë të ndjekë hetimin; ose b) vepron me synimin për të ndaluar materialisht ushtrimin e të drejtave kontraktuale të auditimit apo aksesit në informacion.

ii) Huamarrësi merr përsipër të ndërmarrë një veprim të tillë dhe do të garantojë se Livruesi dhe Përfituesi do të veprojnë kështu, nëse Banka, në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë të hetojë apo t'i japë fund çdo rasti të pretenduar apo të dyshuar të ndonjë sjelljeje të ndaluar në lidhje me Projektin.

iii) Huamarrësi merr përsipër të garantojë dhe duhet të garantojë se Livruesi dhe Përfituesi garantojnë se kontratat e financuara nga kjo Hua përfshijnë dispozitat e nevojshme që t'i mundësojnë Huamarrësit, Livruesit apo Përfituesit, të hetojnë apo t'i japin fund çdo rasti të pretenduar apo të dyshuar të ndonjë sjelljeje të ndaluar në lidhje me këtë Projekt.

b) Sanksionet: Huamarrësi nuk do të bëjë vetë dhe do të garantojë se Livruesi dhe Përfituesi nuk do të: i) përfshihen në një marrëdhënie biznesi me ndonjë person nën sanksione; ose ii) mundësojnë disponimin e fondeve në dispozicion ose përfitimin e tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga një person nën sanksione.

c) Menaxhimi i Huamarrësit: Huamarrësi merr përsipër dhe garanton që Livruesi dhe Përfituesi, brenda një periudhe kohore të arsyeshme, të marrë masat e nevojshme në lidhje me ndonjë anëtar të organeve administrative, i cili:

i) bëhet një person nën sanksione; ose

ii) është subjekt i një vendimi gjykatë të formës së prerë dhe të parevokueshëm në lidhje me një sjellje të ndaluar të kryer gjatë ushtrimit të detyrave të tij/saj profesionale, me qëllim që të garantohej që një person i tillë të pezullohet, hiqet nga puna ose në çdo rast, përjashtohet nga çdo veprimtari e Huamarrësit në lidhje me Kredinë dhe Projektin.

Për qëllimet e kësaj Kontrate:

“Person nën sanksione” nënkupton çdo individ ose njësi të renditur në një apo më shumë lista sanksionesh;

“Lista sanksionesh” nënkupton:

i) çdo masë kufizuese ekonomike, financiare dhe tregtare dhe embargo armësh të lëshuar nga Bashkimi Evropian në zbatim të kapitullit 2, të titullit V, të Traktatit mbi Bashkimin Evropian, si dhe në nenin 215 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian që mund të gjendet në faqet online http://ec.europa.eu/external_relations/cfsp/sanctions/consolist_en.htm, dhe http://eeas.europa.eu/cfsp/sanctions/aocs/measures_en.pdf, të ndryshuar dhe të plotësuar herë pas here ose në ndonjë faqe pasuese; ose

ii) çdo masë kufizuese ekonomike, financiare dhe tregtare dhe embargo armësh të lëshuar nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, që mund të gjendet në faqen zyrtare online të OKB-së <http://www.un.org/Docs/sc/committees/INTRO.htm>, të ndryshuar dhe të plotësuar herë pas here, ose në ndonjë faqe pasuese.”

Neni 6.08

Një nen i ri 6.08 me titull “Libra dhe të dhëna llogarie” do të shtohet pas nenit 6.07 me tekstin e mëposhtëm:

“Huamarrësi,” nëpërmjet Livruesit dhe Përfituesit do të garantojë se Livruesi dhe Përfituesi Përfundimtar:

a) kanë mbajtur dhe do të vazhdojnë të mbajnë libra llogarie të përshtatshëm dhe të dhëna të llogarive, në të cilat do të bëhen hyrje të plota dhe të sakta të të gjitha transaksioneve financiare, aseteve

dhe biznesit të Huamarrësit, duke përfshirë shpenzimet në lidhje me Projektin, në përputhje me GAAP, që është në fuqi herë pas here; dhe

b) mbajnë të dhëna të kontratave të financuara me të ardhurat e Huas, duke përfshirë një kopje të vetë kontratës dhe dokumenteve materiale të lidhura me prokurimin, për të paktën 6 vjet nga data e kontratës.

Për qëllimet e kësaj Kontrate:

“GAAP” nënkupton parimet e kontabilitetit të pranuar përgjithësisht në Shqipëri, duke përfshirë dhe IFRS-në; dhe

“IFRS” nënkupton standardet ndërkombëtare të kontabilitetit brenda kuptimit të Rregullores IAS1606/2002 në masën që është e zbatueshme për deklaratat përkatëse financiare”.

Neni 6.09

Një nen i ri 6.09 me titull “Përfaqësimi dhe garancitë e përgjithshme” shtohet pas nenit 6.08 me tekstin e mëposhtëm:

“Huamarrësi përfaqëson dhe autorizon që ai, Livruesi dhe Përfituesi:

a) janë në përputhje me nenin 6.05/v dhe në dijeninë dhe bindjen e tyre (pasi kanë kryer kërkimin e duhur dhe të kujdesshëm) se nuk ka filluar ose nuk rrezikohet të fillojë asnjë pretendim mjedisor apo social ndaj tij, Livruesit dhe Përfituesit;

b) në dijeninë e tij, asnjë nga fondet e investuara në Projekt nga Huamarrësi, Livruesi dhe Përfituesi ose nga njësitë nën kontrollin e tyre, nuk ka origjinë të paligjshme, duke përfshirë edhe produkte të pastrimit të parave ose të lidhura me financimin e terrorizmit;

c) as Huamarrësi, as Livruesi dhe Përfituesi, si dhe punonjësit dhe drejtuesit e tyre, dhe as ndonjë person tjetër që vepron në emër të tyre ose nën kontrollin e tyre, nuk ka kryer ose nuk do të kryejë: i) ndonjë sjellje të ndaluar në lidhje me Projektin ose transaksionet e parashikuara nga Kontrata; ose ii) ndonjë veprimtari të paligjshme në lidhje me financimin e terrorizmit apo pastrimin e parave; dhe

d) Projekti (duke përfshirë pa kufizim, negocimin, dhënien dhe përmbushjen e kontratave të financuara apo për t’u financuar nga Huaja) nuk ka përfshirë ose nuk ka shkaktuar asnjë sjellje të ndaluar.

Për qëllimet e kësaj Kontrate:

“Pretendim mjedisor apo social” nënkupton çdo pretendim/padi, hetim, njoftim zyrtar ose hetim nga ndonjë person në lidhje me çështje mjedisore apo sociale që ndikojnë te Projekti, duke përfshirë ndonjë shkelje apo shkelje të pretenduar të ndonjë Standardi Mjedisor dhe Social;

“Financim i terrorizmit” nënkupton dhënien apo mbledhjen e fondeve me çdo mjet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me synimin që ato duhet të përdoren ose, në dijeninë se ato janë për t’u përdorur, tërësisht apo pjesërisht, për të kryer vepra penale brenda kuptimit të neneve 1 deri 4 të vendimit kuadër të Këshillit të BE-së 2002/475/JHA të 13 qershorit 2002 për luftën kundër terrorizmit; dhe

“Pastrim i Parave” nënkupton:

i) konvertimin apo transferimin e pronës, duke qenë në dijeni se kjo pronë ka rrjedhur prej aktivitetit kriminal ose nga një veprim i pjesëmarrjes në një aktivitet të tillë, për qëllime të fshehjes apo mbulimit të origjinës së paligjshme të pronës, ose ndihmën për një person që është përfshirë në kryerjen e një aktiviteti të tillë për t’iu shmangur pasojave ligjore të veprimit të tij;

ii) fshehjen apo mbulimin e natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, të drejtave në lidhje me ose në pronësi të pronës, duke pasur dijeni se një pronë e tillë ka rrjedhur nga një aktivitet kriminal ose nga një veprim i pjesëmarrjes në një aktivitet të tillë;

iii) marrjen, zotërimin apo përdorimin e pronës, duke pasur dijeni në kohën e marrjes se kjo pronë ka rrjedhur nga një aktivitet kriminal ose nga një veprim i pjesëmarrjes në një aktivitet të tillë; ose

iv) pjesëmarrjen në, bashkëpunimin për të kryer, tentativën për të kryer dhe mbështetjen, inkurajimin, lehtësimin dhe këshillimin për kryerjen e çdo veprimi të përmendur në pikat e mësipërme.”

Neni 8.01 - Informacion në lidhje me Projektin

1. Pika “i” e nenit 8.01 ndryshohet si më poshtë:

“i) t’i japë Bankës: a) informacion në përmbajtje dhe në formë, dhe herë pas here edhe në kohën e përcaktuar në grafikun A.2 ose siç mund të jetë rënë dakord herë pas here nga palët e kësaj Kontrate; dhe b) çdo informacion i tillë ose dokument tjetër në lidhje me financimin, prokurimin, zbatimin, funksionimin e Projektit dhe çështjeve mjedisore dhe sociale të lidhura me të, siç mund të kërkojë Banka në mënyrë të

arsyeshme brenda një kohe të arsyeshme;”.

2. Një pikë e re “vi” do të shtohet pas pikës “v” me tekstin e mëposhtëm:

“vi) të informojë menjëherë Bankën, për:

a) çdo veprim apo protestë të iniciuar apo çdo kundërshtim i ngritur nga një palë e tretë apo ndonjë kërkesë të mirëfilltë që ka marrë Huamarrësi, Livruesi dhe Përfituesi, apo ndonjë pretendim mjedisor apo social që në dijeninë e tij ka filluar, është pezull apo është deklaruar apo rrezikuar se do të bëhet kundër tij;

b) çdo fakt apo ngjarje në dijeninë e Huamarrësit, Livruesit dhe Përfituesit, që mund të cenojë apo ndikojë kryesisht në kushtet e ekzekutimit ose funksionimit të Projektit;

c) çdo mospërputhje nga ana e tij me ndonjë standard mjedisor dhe social;

d) çdo pezullim, revokim apo ndryshim të ndonjë miratimi mjedisor apo social;

e) një pretendim apo ankesë të mirëfilltë në lidhje me sjellje të ndaluar në lidhje me projektin;

f) në rast vënie në dijeni të ndonjë fakti apo informacioni që konfirmon apo sugjeron në mënyrë të arsyeshme se: a) ka ndodhur ndonjë sjellje e ndaluar në lidhje me Projektin; ose b) ndonjë fond i investuar në kapitalin e tij apo në Projekt, ka rrjedhur nga ndonjë origjinë e paligjshme;

g) një listë e politikave në fuqi që mbulon pronën e siguruar që përbën pjesë të projektit, së bashku me konfirmimin e pagesës për primet aktuale; dhe

h) kopje të vërtetuara të kontratave të financuara me produktet e Huas dhe prova të shpenzimeve për disbursimet.”

Neni 8.02 - Informacion në lidhje me Huamarrësin

Në nenin 8.02 do të shtohen pika të reja “v” deri në “vii” pas pikës “iv” me tekstin e mëposhtëm:

“v) çdo fakt apo ngjarje që rezulton se: a) ndonjë nga anëtarët e vet të organeve administrative apo të Livruesit dhe të Përfituesit; ose b) ndonjë nga njësitë që kanë nën kontroll është Person nën Sanksione;

vi) deri në masën që lejohet nga ligji, çdo proces gjyqësor, arbitrazh, procedim administrativ apo hetimi kryer nga ndonjë gjykatë apo autoritet publik i ngjashëm, që, në dijeninë dhe bindjen e tij, është aktual, brenda një kohe të shpejtë apo pezull kundër Huamarrësit, Livruesit dhe Përfituesit ose njërive që kanë nën kontroll ose anëtarë të njërive administrative të Huamarrësit, Livruesit dhe Përfituesit në lidhje me sjelljen e ndaluar për sa i përket Kredisë ose Projektit; dhe

vii) çdo masë e marrë nga ana e Huamarrësit, Livruesit dhe Përfituesit në zbatim të nenit 6.07 të kësaj Kontrate.”.

Neni 8.03

Nenet aktuale 8.03 dhe 8.04 do të zëvendësohen nga një nen i ri 8.03 me titull “Vizita, të drejtat e aksesit dhe hetimi” me tekstin e mëposhtëm:

“a) Huamarrësi do të lejojë dhe do të garantojë që Livruesi dhe Përfituesi të lejojnë personat e caktuar nga Banka, si dhe personat e caktuar nga institucione të tjera apo organe të Bashkimit Evropian, kur kjo kërkohej nga dispozita përkatëse të detyrueshme të ligjit të Bashkimit Evropian:

i) të vizitojnë vendet, instalimet dhe punët që përfshin projekti dhe të kryejnë kontrolle të tilla siç do të kërkojnë për qëllimet në lidhje me këtë Kontratë dhe me financimin e Projektit,

ii) të intervistojnë përfaqësuesit e Huamarrësit dhe/ose Livruesit dhe/ose Përfituesit, dhe të mos pengojnë kontaktet me ndonjë person tjetër të përfshirë në ose të ndikuar nga Projekti; dhe

iii) të shqyrtojnë librat e llogarisë dhe regjistrat e Huamarrësit dhe/ose Livruesit dhe/ose Përfituesit në lidhje me ekzekutimin e Projektit dhe të jenë në gjendje të bëjnë kopje të dokumenteve të lidhura me to, në masën që e lejon ligji;

b) Huamarrësi do të lehtësojë dhe do të garantojë që Livruesi dhe Përfituesi të lehtësojnë hetimet nga Banka dhe institucione ose organe të tjera kompetente të Bashkimit Evropian në lidhje me ndonjë rast të pretenduar apo të dyshuar për sjellje të ndaluar dhe do t’i japin Bankës, ose do të sigurojnë që banka të pajiset me ndihmën e nevojshme për qëllimet e përshkruara në këtë nen; dhe

c) Huamarrësi pranon që Banka mund të jetë e detyruar t’i komunikojë informacion që lidhet me Huamarrësin, Livruesin dhe Përfituesin dhe Projektin, çdo institucioni apo organi kompetent të Bashkimit Evropian, përfshirë edhe Gjykatën e Audituesve të Bashkimit Evropian, Komisionin Evropian dhe Zyrën Evropiane kundër Mashtrimit, siç të jetë e nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre në përputhje me dispozitat përkatëse të detyrueshme të ligjit të Bashkimit Evropian.”

Ndryshimet në grafikun A

a) Fjalja e fundit e paragrafit A.1.4 me titull “Kalendar” do të ndryshohet dhe lexohet si më poshtë:

“Ndërtimi i terminalit të pasagjerëve tashmë ka përfunduar dhe rehabilitimi i dokeve 7&8 parashikohet në dhjetor 2015”;

b) Tabela aktuale që paraqitet në paragrafin A.1.5 me titull “Skema e financimit dhe kostot e investimit” do të zëvendësohet me tabelën e re siç përcaktohet në aneksin e këtij amendimi nr. 2.

3. DETYRIMET NË VIJIM

Huamarrësi pranon dhe bie dakord që, përveç sa përcaktohet dhe është rënë dakord, kjo letër nuk përbën heqje dorë nga ana e Bankës apo ndryshim të ndonjë afati apo kushti të Kontratës Financiare. Banka rezervon çdonjërin dhe të gjitha të drejtat ligjore dhe kontraktuale që ka sipas Kontratës Financiare dhe ligjin e zbatueshëm.

4. LIGJI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI

4.1 Kjo letër do të administrohet nga Dukati i Madh i Luksemburgut.

4.2 Palët i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatës së Bashkimit Evropian.

Palët e këtij amendimi nr. 2 të Kontratës Financiare heqin dorë nga çdo imunitet apo e drejtë që të kundërshtojnë juridiksionin e këtyre gjykatave. Një vendim gjykate që jepet në zbatim të këtij neni, do të jetë përfundimtar dhe detyrues për çdo palë, pa kufizim apo rezervë.

Nëse jeni dakord me sa më sipër, lutemi që 2 (dy) kopje origjinale të kësaj letre t’i kthehen Bankës në vëmendje të z. Lawrence Walsh (tel. +352437983477, e-mail: l.walsh@eib.org), të sigluar në çdo faqe, duke vendosur datën dhe nënshkrimin sipas rregullave dhe në emër të Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e Huamarrësit deri dhe jo më vonë se data 14 nëntor 2014. Pas kësaj date, Banka rezervon të drejtën, në gjykimin e saj, me njoftim ndaj Huamarrësit, të konfirmojë nëse pranimi i kësaj letre nga Huamarrësi konsiderohet si i dhënë në mënyrë të vlefshme nga Huamarrësi.

Lutemi, gjithashtu, t’i dërgohet për dijeni një kopje e këtij amendimi nr. 2, kur të jetë nënshkruar sipas rregullave, ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve.

Me respekt

Banka Evropiane e Investimeve

Dominique COURBIN

Massimo NOVO

Pranuar dhe rënë dakord nga dhe në emër të Republikës së Shqipërisë

Përfaqësuar nga Ministria e Financave

(emri dhe funksioni)

Data:

ANEKS I AMENDIMIT NR. 2 TË KONTRATËS FINANCIARE

Përshkrimi	(M EURO)	Në përqindje të kostove bazë
Marrja e sipërfaqes së tokës		
Projekti dhe mbikëqyrja	3.41	8.53 %
Terminali i trageteve	25.00	62.50 %
Elemente ndihmëse dhe rehabilitimi i dokeve 7 & 8	10.87	27.17 %
Aspekte fizike të paparashikueshme	0.72	1.80 %
Kostoja bazë	40.00	100 %
Paparashikueshmëria e çmimeve	0.00	0 %
TVSH	-	-
Kostoja totale e investimit	40.00	100 %